



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:175283

Datë: 27.10.2023

Numri i dokumentit: 04842011

C.nr.5364/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. I. K nga - komuna e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R. S, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës komuna e Obiliqit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, në kontestin për kompensimin për punë gjatë ndërrimeve të natës dhe kujdestarive, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.10.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit G. I. K nga Prishtina me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura komuna e Obiliqit që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave për punë gjatë ndërrimit të natës dhe kujdestarisë, për periudhën kohore nëntor – dhjetor 2012 dhe në tërësi për vitin 2013, si dhe shpenzimet procedurale, me kamatë ligjore që nga dita e parashtrimit të padisë e deri në ditën e pagesës definitive të mjeteve, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”, për shkak të parashkrimit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi G. I. K, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datë 11.12.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës komuna e Obiliqit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, me të cilën ka kërkuar kompensimin për punë gjatë ndërrimeve të natës dhe kujdestarive, për periudhën kohore nëntor – dhjetor 2012 dhe në tërësi për vitin 2013. Paditësi në padi ka theksuar se është në marrëdhënie të punës tek e paditura. Ndërsa ka theksuar se, këtë kërkesë e mbështetë në vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë të datës 04.06.2013, numër 05-3313, për themelimin e grupit punues për harmonizimin e pagesës së kujdestarive, sipas kontratës kolektive. Tutje ka theksuar se i janë drejtuar me shkrim të paditurës në lidhje me këto pagesa, mirëpo e paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit në mënyrë kategorike. Në fund ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar dhe kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit dhe kërkesën e tij si të pabazuar. Ka theksuar se padia e paditësit është e pabazuar, ngase sipas shkresave të lëndës paditësi nuk ka bërë asnjë veprim juridik që nga viti 2012 e deri në dhjetor të vitit 2020 në lidhje me kërkesën e tij për kompensimin e mjeteve për ndërrimin e natës dhe kujdestarinë. Tutje ka theksuar se paditësi ka ushtruar profesionin e mjekut në QKMF në Obiliq, dhe se i njëjti nuk ka bërë asnjëherë kërkesë gjatë periudhës së lartcekur për kompensim. Tutje ka theksuar se e paditura konsideron se paditësi ka kërkuar kompensimin e kujdestarive dhe ndërrimit të natës jashtë afatit ligjor, duke cituar nenin 87 të Ligjit të Punës, dhe se afati për parashtrimin e kësaj padie ka kaluar, për arsye se me këtë rast nga muaji nëntor dhe dhjetor 2012 dhe tërë viti 2013, kanë kaluar më shumë se tetë (8) vite. Në fund nga gjykata ka kërkuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e deklarimeve të të dyja palëve ndërgjyqëse në padi dhe në përgjigje në padi, vlerësimin e provave të bashkëngjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk kontestohet gjendja faktike, porse i padituri ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesës së paditësit në raport me të. Si rrjedhim, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike-kontestimore, nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritator jashtë seancës gjyqësore.

Me nenin 399, par. 1 të LPK-së, parashihet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*. Mbi bazën e kësaj dispozite, duke u bazuar në faktet e treguara në padi, e duke u bazuar edhe në prapësimet materiale-juridike të ngritura nga e paditura përmes përgjigjes në padi, gjykata vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e këtij llojit të vendimit gjyqësor për shkakun se nga to, rezulton qartazi pathemelësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Kështu, përmes padisë, paditësi ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura që në emër të punës gjatë ndërrimeve të natës dhe kujdestarive t’ia kompensoj paditësit mjetet financiare vlera e të cilave do të përcaktohej nga ekspertiza financiare, për periudhën kohore nëntor – dhjetor 2012 dhe në tërësi për vitin 2013.

Neni 87 i Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Sipas nenit 341, paragrafi 1 të LMD-së, me parashkrim pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Ndërsa sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, parashihet se *“parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit”*.

Neni 342, par. 1 të LMD-së parasheh se *“parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste*

të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa sipas nenit 342 të të njëjtit ligj parashihet se *“parashkrimi lind kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj”*.

Gjykata e gjen si të themeltë prapësimin e të paditurës se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ngase e njëjta është përfshirë në parashkrim. Gjykata vë në dukje se kërkesa e paditësit i referohet kompensimit për punë gjatë ndërrimeve të natës dhe kujdestari, për periudhën kohore nga nëntori – dhjetori i vitit 2012, dhe tërë viti 2013, e që për gjykatën kjo është periudha kohore kur fillon të rrjedhë llogaritja e afatit të parashkrimit të kërkesës së paditësit në raport me palën e paditur. Paditësi padinë e ka paraqitur në gjykatë me datë 11.12.2020, gjë që konstatohet nga vula e dorëzimit të saj në gjykatë, çka rezulton se padia është ushtruar pas kalimit të afatit 3 vjeçar dhe si rrjedhojë gjykata ka konkluduar se kërkesa për mbrojtje gjyqësore për paditësin lidhur me kompensimin e pagës për punë gjatë ndërrimeve të natës dhe kujdestari, është e parashkruar.

Sipas nenit 369 të LMD-së, parashihet se *“parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Pra, sipas këtij përkufizimi ligjor, kreditori duhet të ndërmarrë veprime në drejtim të debitorit, në mënyrë që të ndërpritet parashkrimi, veprime këto që i drejtohen një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent. Paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurës, e parashtruar në gjykatë me datë 11.12.2020, rrjedhimisht pas kalimit të afatit ligjor. Në procedurë gjyqësore nuk është prezantuar asnjë provë apo fakt, i cili do të kishte rëndësinë vendimtare të ndërprerjes së afatit të parashkrimit ndaj të paditurës aktuale, që rrjedhimisht do të përbënte shkak që koha e kaluar e parashkrimit të mos llogaritet, dhe që parashkrimi të fillonte nga fillimi.

Vendimin në lidhje me shpenzimet e procedurës gjyqësore, gjykata e ka bazuar në nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, lidhur me nenin 450, meqenëse pala e paditur nuk i ka specifikuar këto shpenzime.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5364/20/2020, datë 25.10.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*